

BOTA^e



BOTIM SPECIAL
SHKURT

2023

Ponari: SIGAL UNIQA, 24 Vjet Histori Suksesi fq. 3

15 vjet UNIQA, 15 vjet unikë fq. 5

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut fq. 8

SIGAL UNIQA mes TOP 100 kompanive të
sigurimit në Europën Juglindore fq. 15

Produktet dhe shërbime që përmirësojnë jetën fq. 24

Më shumë se një kompani sigurimi fq. 30

UNIQA gjatë vitit 2022 fq. 33

SIGAL UNIQA

**bashkëpunimi shqiptaro-austriak
që shenjoji historikun e sigurimeve**

Përmbajtja

Ponari: SIGAL UNIQA, 24 Vjet Histori Suksesi	fq. 3
15 vjet UNIQA, 15 vjet unikë	fq. 5
Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri.....	fq. 8
Tregu i Pensioneve private vullnetare gjatë vitit 2022	fq. 10
Tregu i sigurimeve në Kosovë	fq. 12
Tregu i sigurimeve në Maqedoninë e Veriut	fq. 13
Analiza vjetore 2022	fq. 14
Workshop / Dëmet pasqyra e kompanisë	fq. 16
SIGAL UNIQA mes TOP 100 kompanive të sigurimit në Europën Juglindore	fq. 15
Oda Ekonomike e Kosovës vlerëson SIGAL UNIQA-n	fq. 17
UNIQA Maqedoni vlerësohet me çmim nga faqja e njohur ndërkombëtare	fq. 18
Produktet dhe shërbime unike që përmirësojnë jetën	fq. 24
AutoSOS	fq. 24
Sigurimi Anti-Tumor	fq. 26
Bli Online Siguracionin që të duhet	fq. 28
Më shumë se një kompani sigurimi	fq. 30
Përgjegjësia Sociale	fq. 30
Kulturë	fq. 31
Sport	fq. 32
UNIQA gjatë vitit 2022	fq. 33

Avni Ponari, CEO
SIGAL UNIQA Group Austria

SIGAL UNIQA, 24 VJET HISTORI SUKSESI

Gjithçka nisi me një rrugëtim që u konkretizua në shkurt 1999 por që ishte nisur shumë më herët.

Ishin 5 veta, 1 zyrë dhe një kapital prej vetëm 400 mijë dollarësh. Ndërsa sot kryesojnë tregun, janë në avangarde me kompanitë simotra dhe numërojnë mbi 2100 punonjës e agentë dhe mbi 1150 zyra.

Ka qenë një rrugëtim i gjatë, i lodhshëm, me shumë sfida, por edhe i bukur kur shikon se sa shumë besim i ka dhënë qytetarëve, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Shumëkujt sot i duket e pabesueshme, por kur e dashuron diçka çdo vështirësi zbehet dhe bëhen të papërfillshme.

Po flasim për SIGAL, kompaninë lider të sigurimeve, fillimisht në Shqipëri e më pas në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Është pak e vështirë të rikthehesh 24 vite pas kur lindi ideja për të zhvilluar një kompani sigurimesh private. Unë vij nga shkolla e Marinës, ky është edukimi im i lartë, të cilin e kam mbaruar në Vlorë. Në atë kohë, vetëm Marina ishte e përfshirë në sistemin e sigurimeve. Anijet shqiptare ishin të vetmet të siguruara, pasi nuk mund të lundronin në asnjë port të botës pa qenë të siguruara. Ndaj, sigurimi ishte një nga lëndët që ne bënim në shkollën e lartë. Pasi u largova nga detyra e rëndësishme që kisha në 1992-shin, fillova punë në kompaninë e parë të sigurimeve, në departamentin e marinës (të cilin e krijova unë). Më tej, në '96 - '97-ën, krijuam ligjin për liberalizimin e tregut të sigurimeve dhe unë isha pjesë e hartimit të këtij ligji. Ndërsa në vitet '98 - '99, filluam përgatitjet për të krijuar e kompaninë e parë të sigurimeve së bashku me disa miq të mi që punonin në sigurime.

Në patëm fatin që në kohën që punuam në kompaninë e parë të sigurimeve në Shqipëri, u trajnuam nga kompanitë më të mëdha europiane dhe të SHBA-së në tregun e sigurimeve. Ne ishim të ftuar nga Lloyd's në Londër, etj dhe kjo na dha mundësinë për të kapur atë që nuk patëm mundësi ta bënim në kohën e diktaturës. Trajnimet tona ishin të jashtëzakonshme, ndaj dhe kishim marrë bazat për të qenë drejtues në industrinë e sigurimeve.

Ideja lindi për të krijuar një kompani sigurimesh, por ishte e vështirë për disa faktorë. Fillimisht, ishte e vështirë të përballeshe me një kompani shtetërore, e cila në '97 kishte kapital mbi 15 milionë dollarë dhe kishte 1500 punonjës, gjithashtu, opinionin publik po përballej me idenë e kompanive të sigurimit, menjëherë pas 'Piramidave' dhe ishte e vështirë të thyje opinionin e krijuar në masë.

E treta ishte shumë e vështirë të gjeje njerëz për të punuar dhe përgatitur. Kështu që së bashku me 5 miqtë e mi që ishim fillestar të idesë, punuam rreth 1 vit e gjysmë derisa e hartuam gjithçka për të krijuar kompaninë. Së bashku me dy biznesmenë, në atë kohë arritëm dhe morëm licencën. Pra në qershor të 1999-ës morëm licencën dhe në shkurt është dita e krijimit, kur vendimi i gjykatës hyri në fuqi, ndërsa 'polica' e parë u shit në qershor".

SIGAL UNIQA, jo thjesht një kompani Sigurimi
Avni Ponari: "SIGAL nuk është thjesht një kompani që merret me sigurimin dhe pagesën e dëmeve, por është pjesë e shumë strukturave sociale. Është mbështetëse e shumë aktiviteteve kulturore, sportive apo nevojave të njerëzve që duhen ndihmuar, por këto janë bërë në heshtje, pa zhurmë. Sigali ka bërë edhe disa platforma digjitale shumë të rëndësishme si "Audio Books", e cila është platforma e parë shqip ku njerëzit mund të dëgjojnë libra në Shqip. Aktulisht është kaluar numri i 300 librave të kategorive të ndryshme që mund të dëgjohen dhe ka mbi 50 mijë persona në gjithë botën që e ndjekin, sigurisht duke u shtuar. Nga ana tjetër jemi përpjekur të ofrojmë shërbime online për raportim dëmsh, që të ketë një hapësirë që njerëzit të jenë sa më afër me Sigalin, por

edhe mos humbasim kohë. Kemi gjithashtu një platformë shëndetësore, ku klientet tanë mund të flasin me doktorin gjatë gjithë ditës online. Po ashtu kemi dhe një platformë, ku ndiqet Shqipëria live nga çdo vend i botës. Pra në këtë pikëpamje ne jemi përpjekur të jemi sa më afër njerëzve dhe mos bëjmë vetëm mbulimin e sigurimeve dhe dëmeve.

Nga ana tjetër kemi mbështetur sportin, si sponsor zyrtar i Federatës së Futbollit në Shqipëri, gjithashtu i skuadrës së futbollit të femrave në Kosovë, apo Federatës së Basketbollit Kosovë. Të gjitha këto, e kanë bërë Sigalin më të njohur dhe më afër njerëzve. Në të ardhmen, programet tona janë ambicioze dhe po punojmë për të ndërtuar gjëra që të jenë të prekshme dhe që janë aty ku njerëzit kanë më shumë nevojë për ne".

Korrektësia ndaj klientëve, pagimi i dëmeve në kohë, profesionalizmi i stafit, produktet novatore për tregun dhe mundësia për sigurime për çdo shtresë të shoqërisë ka bërë që sot SIGAL UNIQA Group Austria të besohet nga mbi 1 milion qytetarë në tre shtetet ku operon, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ndaj drejtuesi i Grupit SIGAL, Z. Avni Ponari ka një falenderim për të gjithë ata që jetën, shëndetin, pronën, automjetin, pensionin privat ia besojnë pikërisht këtij emri që ka shenjuar historinë e sipërmarrjes së lirë në Shqipëri dhe jo vetëm.

Avni Ponari: "Për ta mbyllur, dua të shtoj që këto projekte dhe kanë përherë mbështetjen e klientëve tanë, ndaj jemi përpjekur që të jemi besnik ndaj tyre, t'u japim besim dhe sot ne kemi mbi 1 milionë e gjysmë klientë në 3 shtete, duke treguar që jemi pranë tyre dhe me ta, si një familje bashkë me Sigalin. Fundja, misioni ynë është t'i ndihmojmë ata në raste fatkeqësie për t'i kthyer në gjendjen e mëparshme financiare, shëndetsore etj. I falenderoj të gjithë dhe ju them që gjithmonë do jemi pranë jush".

Z. Avni PONARI.
CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA
Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë

Andreas Brandstetter, CEO
Uniqa Insurance Group

15 VJET UNIQA, 15 VJET UNIKË

2022 ishte dhe një vit jubile për SIGAL UNIQA Group Austria.

Më 23 mars u kremtua 15-vjetori i futjes në tregun shqiptar të sigurimeve të një prej kompanive lider në Europën Qëndrore dhe Lindore, "UNIQA Insurance Group", i pari investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve, me një potencial të jashtëzakonshëm dhe me një eksperiencë mbi 200-vjeçare në këtë sektor.

Në vitin 2007 UNIQA vendosi të blejë një pjesë të aksioneve të SIGAL, duke u kthyer kështu në një partner kyç për SIGAL, por edhe një faktor të rëndësishëm për tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

"UNIQA Insurance Group" ishte dallëndyshja e parë nga Europa që vendosi të investojë në tregun financiar shqiptar dhe atë të rajonit dhe sot është më e besuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ndërsa falë produkteve të saj në sigurime rrit numrin e klientëve ditë pas dite.

Dhe SIGAL gëzon meritën për futjen në tregun shqiptar të sigurimeve të të parit investitor strategjik european në industrinë e sigurimeve, me një potencial të jashtëzakonshëm dhe me një eksperiencë mbi 200-vjeçare në fushën e sigurimeve.

Po si kanë qenë këto 15 vite të UNIQA në Shqipëri?

CEO i Grupit, Dr. Andreas Brandstetter shprehet i lumtur nga bashkëpunimi me SIGAL, bashkëpunim sipas të cilit i ka tejkaluar pritshmëritë e "UNIQA Insurance Group".

Andreas Brandstetter: “Është një treg i mrekullueshëm sepse ndodhet në një zonë të bukur të Europës, të zbuluar vonë dhe me popullsi shumë të re. Është në prosperitet dhe ka shumë potencial sepse ka shumë rezerva natyrore. Ka një potencial të madh për turizëm, për energji, për tregti.

Është afër Austrisë dhe të gjitha planet që kemi pasur dhe të gjitha pritshmëritë që kemi pasur janë përmbushur plotësisht. Disa gjëra janë mbipërmbushur kështu që jemi shumë të lumtur”.

Andreas Brandstetter: “24 vjet më parë SIGAL UNIQA nuk ekzistonte. Së bashku me një grup të vogël prej disa personash Avni Ponari vendosi të ngrinte një kompani nga hiçi dhe sot SIGAL UNIQA është grupi më i madh i sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, e cila mbështet miliona klientë për të pasur një jetë më të mirë dhe më të sigurtë. Jemi kaq krenarë që kemi SIGAL Uniqa pjesë të familjes tonë europiane.

SIGAL UNIQA është një kompani e cila jo vetëm mbledh të ardhura, por i kthen mbrapsht ato në shoqëri, jo vetëm përmes dëmshpërblimit të klientëve por edhe për komunitetin, duke ndihmuar dhe mbështetur financiarisht aktivitete të llojeve të ndryshme. Këto janë kompanitë e mëdha dhe këto janë njerëzit e mëdhenj si Avniu”.

Për z. Andreas Brandstetter, Shqipëria është një vend me potenciale të shkëlqyera zhvillimi ndërsa shqiptarët miqësorë, të hapur dhe shumë mikpritës. Por ai ve theksin edhe tek një tjetër detaj, durimi i shqiptarëve siç e quan ai, gjë e cila i nevojitet edhe austriakëve.

Andreas Brandstetter: “Për këtë flas shpesh me mikun tim Avni Ponari, për durimin e shqiptarëve. Kur shoh ndonjëherë fotot e luftërave austriake në të kaluarën, kur dëgjoj prindërit e mi duke folur, atëherë them se kemi nevojë për durimin e shqiptarëve.

Ky është një vend kaq i madh në potenciale dhe unë këtu përfshij edhe Kosovën, edhe Maqedoninë e Veriut. Por shoqëria, politika kanë nevojë për kohë për tu zhvilluar. Do të ketë ulje dhe ngritje por potenciali është aq i madh sa nuk mund të mos shoh një të ardhme të ndritur për Shqipërinë, jo vetëm për tregun e sigurimeve, por për të gjithë vendin. Është pjesë e Europës dhe ashtu siç do të zhvillohet tregu i sigurimeve, do të zhvillohet edhe tregu financiar i gjithë vendit. Keni menaxhuar kaq shumë kriza në të shkuarën, aq shumë kriza sa jam i bindur 100% se e ardhmja do të jetë një e ardhme shqiptare. Një e ardhme e mirë dhe ne duam të jemi pjesë e saj sigurisht”.

Çfarë mendon Andreas Brandstetter kur dëgjon të përmenden Shqipëria dhe shqiptarët?

Andreas Brandstetter: “Njerëz miqësorë, shumë kulturë. Mendoj Skënderbeun, sigurisht, që është pjesë e kulturës europiane. Më vjen ndër mend familja sepse disa prej miqve të mi më të mirë jetojnë në Shqipëri dhe kjo është familje, është arsyeja pse Shqipëria është një pjesë e zemrës sime.

Gjithashtu më pëlqen kultura shqiptare, mënyra se si vendi është i hapur, mikpritja, ushqimi. Është ushqim i mrekullueshëm, më i miri dhe njerëzit janë kaq mendjehapur. Kështu, mendoj se të gjithë, shqiptarë dhe austriakë, të gjithë kemi pjesë shumë të mira dhe do të ishte mirë të kombinonim pjesët tona më të mira”.

Dhe në fund nuk mund të mungonte edhe një falenderim në gjuhën shqipe.

Andreas Brandstetter: “Pra, të gjithë popullit shqiptar FALEMINDERIT! Faleminderit për gjithçka dhe mezi pres të kthehem në Shqipërinë e bukur!”

Z. Andreas BRANDSTETTER
CEO i UNIQA Insurance Group

Të zgjedhësh UNIQA është vendimi për një jetë më të mirë



22.400
Punonjës

16 milionë
Klientë

18
Shtete

Një prej kompanive më të mëdha të sigurimeve në Europën Qendrore dhe Lindore.

SIGAL UNIQA kompania lidere e sigurimeve

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-dhjetor 2022

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) publikoi këtë fillimviti raportin mbi ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-dhjetor 2022.


Sipas AMF, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-dhjetor 2022 kapën vlerën 21,033 milionë lekë, ose 9.16% më shumë se në janar-dhjetor 2021.

Gjatë së njëjtës periudhë numri i kontratave të sigurimit të lidhura shënuan një rritje prej 12.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërkohë, tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.75% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.01%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.84% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.16% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, raporton AMF, dëmet



e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,830 milionë lekë, ose 2.39% më shumë se në periudhën janar-dhjetor 2021.


Primet e sigurimit vullnetar, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 arritën rreth 7,959 milionë lekë, 7.71% më shumë se në periudhën janar-dhjetor 2021 ndërsa numri i kontratave të sigurimit vullnetar u rrit me 9.15% krahasuar me periudhën janar-dhjetor 2021.

Primet e sigurimit vullnetar të Jo-Jetës gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, patën një rritje me 4.93% kundrejt

periudhës janar-dhjetor 2021.

Primet nga sigurimet e Jetës gjatë periudhës janar - dhjetor 2022, arritën rreth 1,685 milionë lekë, ose 17.84% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SIGAL UNIQA Group Austria, lidere në tregun e sigurimeve Edhe pse kanë kaluar 24 vjet



nga themelimi i saj, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet në krye të sigurimeve të Jo-Jetës duke zënë 27% të tregut ku operojnë 8 kompani dhe 46 të tregut të Sigurimeve të Jetës ku operojnë 4 kompani.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA vijon të jetë lidere e tregut shqiptar për të gjitha llojet e siguracioneve:

- Në SIGURIMIN E JETËS, duke zotëruar 45.74% të tregut

- Në SIGURIMIN E JO JETËS, duke zotëruar 26.76% të tregut

- Në SIGURIMIN E DETYRUESHËM, duke zotëruar 21.12% të tregut



- Në SIGURIMIN VULLNETAR, duke zotëruar 38.61% të tregut

- Në SIGURIMIN E PRONËS, duke zotëruar 45.74% të tregut


- Në SIGURIMIN E AKSIDENTEVE DHE TË SHËNDETIT, duke zotëruar 48.35% të tregut

- Në SIGURIMIN MOTORIK, duke zotëruar 21.36% të tregut


Besueshmëri, garanci, stabilitet financiar dhe standarde evropiane për të gjithë klientët dhe partnerët tanë!



Sigurimi i Detyrueshëm



Sigurimi Vullnetar




Pensionet private gjatë vitit 2022

SIGAL UNIQA Fond Pensioni ruan lidershipin në treg

Vlera e aseteve neto të FP

Burimi: Raporti i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare



Edhe gjatë vitit 2022, investimet e Fondeve të Pensioneve janë bërë në bono thesari dhe obligacione shtetërore.

PSE SHQIPTARËT I BESOJNË SIGAL UNIQA FOND PENSIONI?

Aktiv prej 17 vitesh në treg, në të gjithë Shqipërinë

Mbi 22 milionë euro asete në administrim të 12.000 klientëve dhe 140 bizneseve

Pjesë e UNIQA INSURANCE Group prej vitit 2007

Të drejtën për tu anëtarësuar e kanë të gjithë personat, pavarësisht nga mosha, vendndodhja dhe punësimi

Është një Fond Pensioni me kontribute individuale të përcaktuara
- Kontributi minimal është 1,000 lekë në muaj

Kontributet për pension privat mund ti paguajnë individët anëtarë të Fondit, punëdhënësit e tyre, ose çdo person i tretë në emër të tyre në lekë

Kontributi për pension mund të paguhet sipas dëshirës dhe mundësisë në baza mujore, 3-mujore, 6-mujore ose vjetore, etj

Kontributet mund të paguhen edhe si shumë e menjëhershme

Asetet e Fondit investohen më synim rritjen e kthimit nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'i siguruar atyre një të ardhme të sigurt

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikoi raportin mbi ecurinë e tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri për vitin 2022.

Sipas AMF, gjatë vitit 2022, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare tregon një total asetesh neto prej 5,699.38 milionë lekë (49.89 milionë euro) dhe me një rritje prej 1,114.84 milionë lekë krahasuar me një vit më parë.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.12.2022 rezultoi 36,518 anëtarë duke shënuar një rritje prej 8.78% krahasuar me 31.12.2021.

Sa i përket aseteve neto, SIGAL UNIQA Fond Pensioni vijon të mbetet lidere në treg, me mbi 43% të totalit të aseteve, me një diferencë të konsiderueshme me 3 operatorët e tjerë në treg.

Pagesa e përfitimeve ofrohet për anëtarët e Fondit në format e: a) Pension Pleqërie të Parakohshëm; b) Pension Pleqërie; c) Pension Invaliditeti; d) Pension familjar;

Në rast humbje jete si anëtar të Fondit, asetet e mbetura në llogarinë tuaj do t'u shpërndahen trashëgimtarëve sipas aktit të trashëgimisë.

Transparencë në kohë reale përmes faqes zyrtare në internet: www.fondisigal.com.al

Bonuse për klientët (Duke qenë pjesë e "SIGAL

UNIQA Group Austria", me anëtarësimin në SIGAL UNIQA FOND PENSIONI, krahas kursimeve tuaja që rriten, keni mundësinë që vetëm me kartën e anëtarësisë të përfitoni nga bonuset fantastike që ju ndihmojnë të kenë akses në shërbime e produkte cilësore).

Një Fond Pensioni Privat Vullnetar i ofron anëtarëve të tij mundësinë e një pensioni të përshtatshëm për të ruajtur standardin e jetesës sipas kërkesave dhe nevojave të tyre, duke maksimizuar përfitimet nëpërmjet një administrimi të kujdesshëm të aseteve.

RAPORTI STATISTIKOR 31.12.2022

Portofoli i Investimit të SIGAL UNIQA Fond Pensioni

2,414,338,423 Lekë

Vlera e aseteve neto

2,487,072,572 Lekë

Numri i kuotave

1,557,013

Asetet neto për kuotë

1,597 Lekë



Jo vetëm në Shqipëri

SIGAL UNIQA, lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

Sipas raportit të publikuar nga Banka Qëndrore e Kosovës për vitin 2022, në sigurimet e Jo-Jetës, SIGAL UNIQA Group Austria kryeson tregun duke zënë 13% të totalit të tij nga 12 kompani që operojnë në treg.

Edhe sa i përket dëmeve të paguara në sigurimet e Jo-Jetës, SIGAL UNIQA Kosovë rënditet e para me mbi 7.8 milionë Euro të paguara tek klientët e saj dhe me një rritje prej rreth 1.2 milionë (6,639,264) krahasuar me vitin 2021.


Në Sigurimet Motorike, SIGAL UNIQA Kosovë rënditet e para në treg, duke zënë mbi 12% të tij dhe me prime të shkruara prej mbi 10,1 milionë Eurosh, duke regjistruar kështu një rritje prej rreth 1.2 milion Eurosh (8,961,210) krahasuar me vitin 2021.

Në Sigurimin nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe dëmtimet e tjera në pronë, SIGAL UNIQA Group Austria Kosovë rënditet kompania më e besuar nga qytetarët dhe ajo që paguan më shumë dëme.

Edhe në dëmet e paguara në Sigurimet e Pronës gjatë vitit 2022, SIGAL UNIQA Kosovë rënditet kompania numër 1.

Sa i përket produktit “Aksidente dhe Shëndet”, SIGAL UNIQA Kosovë ka një rritje krahasuar me vitin 2021. (Nga 2,94 milionë Euro në 3,67 milionë euro për vitin 2022)

Edhe sa i përket dëmeve të paguara, SIGAL



UNIQA Kosovë ka shënuar rritje në pagesa duke dëmshpërblyer rreth 2 milionë Euro tek klientët e saj. Ndërsa një vit më parë paguante 1,8 milionë Euro.

Edhe në Sigurimet e Jetës, SIGAL Kosova LIFE ka regjistruar një performancë të mirë duke u rritur nga 4,85 milionë Euro në vitin 2021 në rreth 6,4 milionë Euro gjatë vitit 2022.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova u krijua në vitin 2003 duke shënuar zbatimin e strategjisë për ndërkombëtarizimin e SIGAL sh.a (themeluar në vitin 1999 në Tiranë) përmes blerjes së një shoqërie ekzistuese sigurimi.

SIGAL UNIQA Kosovë ka shtrirë shërbimin e saj si për nga numri i produkteve që ofron ashtu edhe gjeografikisht përmes dhjetra degëve dhe agjencive të veta në Deçan, Dragash, Elezit, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Gllogoc, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtërpçë, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Xërxë.

Jo vetëm në Shqipëri

Viti 2022, vit i suksesshëm për Grupin SIGAL UNIQA

Përveç sukseseve në Shqipëri dhe Kosovë, edhe në Maqedoninë e Veriut “UNIQA Macedonia” ka arritur rezultate të kënaqshme, në rritje krahasuar me vitin 2021.

Sipas raportit të ASO (Agjencia e Mbikqyrjes Financiare), gjatë vitit 2022 “UNIQA” numëron 1,141,732,000 Denarë prime (rreth 18,7 milionë euro). Ndërsa gjatë vitit 2021 regjistron 1,023,456,000 Denarë prime (rreth 16,7 milionë Euro). Një rritje me 2 milionë Euro brenda vitit.

Nëse gjatë vitit 2021, në Sigurimet e Jo-Jetës, ku operojnë 11 kompani, “UNIQA” zinte 8.8% të tregut, gjatë vitit 2022 ze 9.3% të tij.

Edhe sa i përket dëmeve të paguara në Sigurimet e Jo Jetës, “UNIQA Macedonia” ka shënuar rritje krahasuar me një vit më parë duke dëmshpërblyer klientët e saj në vlerën e 409,489,000 Denarë (ose 6,7 milionë Euro)

Edhe sa i përket Tregut të Sigurimeve të Jetës, “UNIQA LIFE” regjistron rritje krahasuar me një vit më parë.

Gjatë 2021-it kompania numëronte 247,416,000 Denarë prime (rreth 4 Milionë Euro) ndërsa gjatë vitit 2022 285,401,000 Denarë prime (rreth 4.7 milionë Euro). Një rritje vjetore prej 700 mijë eurosh.

Sa i përket dëmeve të paguara, krahasuar me vitin 2021, “UNIQA LIFE” shënon rritje duke dëmshpërblyer klientët e saj në vlerën e 51,711,000 Denarë (846,000 Euro)


Kompania e sigurimeve “UNIQA Macedonia”,

pjesë e SIGAL UNIQA Group, prej 18 vitesh në tregun maqedonas të sigurimeve, ka shënuar suksese të jashtëzakonshme ndërsa ka ditur t’ju shërbejë klientëve mirë, t’ju japë produktin e nevojshëm që ata duan.

Kompania ka qenë gjithmonë afër klientëve, jo vetëm kur marrin primin por veçanërisht kur ata kanë nevojë dhe kur duhet paguar dëmi.

Ajo ka ditur gjithashtu të jetë edhe pranë komunitetit me aktivitete të ndryshme ku ka marrë pjesë ose ka sponsorizuar.

Sruktura e primeve sipas shoqërive të Jo-Jetës 2022



Analiza Vjetore 2022

Ponari: Jemi e vetmja kompani në vend që ofron të gjitha produktet e sigurimit që një qytetari i nevojitet



SIGAL UNIQA Group Austria zhvilloi në muajin janar Analizën e kompanisë për vitin 2022 dhe objektivat për vitin 2023.

Gjatë fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm i Grupit, z. Avni Ponari falenderoi stafin në drejtorinë qendrore dhe në degët kudo në Shqipëri për punën e kryer gjatë vitit të shkuar.

Sipas z.Ponari, të qënurit pjesë e një gjigandi si “UNIQA Insurance Group”, pagesat e drejtpërdrejta te klientët, aftësia paguese si asnjë kompani tjetër sigurimi në Shqipëri, e bëjnë SIGAL UNIQA Group Austria kompaninë lider dhe më të besuar të sigurimeve që prej 24 vjetësh.

“Jemi krenarë që si Grup vijojmë të udhëheqim tregun e sigurimeve me mbi 30% të tij. Me 3 kompani, SIGAL JO JETA, SIGAL JETA dhe Fondi i Pensioneve Private SIGAL jemi e vetmja kompani në vend që ofron të gjitha produktet e sigurimit që një qytetari i nevojitet”.

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria përsëriti edhe një herë angazhimin e kompanisë për të qenë pranë klientëve atëherë kur ata kanë më shumë nevojë ndërsa produktet më të reja që ka sjellë ajo si: “SIGAL AutoSOS” me mbulim territorin e Shqipërisë dhe “Sigurimi Anti-Tumor” vijnë për ta bërë sa më të prekshme te qytetarët moton e kompanisë “Jetojmë më mirë së bashku”.





Workshop-i rajonal Dëmet e paguara, çelësi i suksesit për SIGAL UNIQA

Më 9 Prill 2022, Grupi SIGAL UNIQA zhvilloi në qytetin e Strugës workshop-in rajonal me titull “Dëmet, pasqyra e kompanisë”.

I gjithë workshop-i e vuri theksin tek pagesa e dëmeve, të cilat janë pasqyrim i punës së kompanisë dhe që krijojnë besimin ndaj saj dhe e vendosin atë në fokusin e qytetarëve.

“Thelbi është të jemi afër klientëve dhe tu shërbejmë atyre drejtëpërdrejtë, pa ndërmjetës dhe ndërhyrje. Të gjitha këto, dhe jo vetëm, e bëjnë SIGAL UNIQA-n një kompani efikase duke rritur rolin e saj në treg dhe duke shtuar besimin te qytetarët.

SIGAL UNIQA, siç duhet ta ketë çdo kompani sigurimi, ka në fokusin e saj të përditshëm pagesën e dëmit dhe dergimin e tij tek i dëmtuari apo përfituesi i drejtëpërdrejtë.

Vitin e shkuar kemi paguar mbi 40 milionë euro ne te tre shtete”, tha ndër të tjera z. Ponari, shifër kjo që tregon madhësinë dhe seriozitetin e SIGAL UNIQA. Dhe kane qene perfitues mbi 20 mije klienta pra shifer e konsiderueshme.

Në tregun ku operon SIGAL UNIQA qytetarët shpenzojnë mesatarisht rreth 40 euro për frymë për sigurime dhe nëse kjo shifër do të ishte 100, 200 euro apo rreth 3000 euro si në vendet e BE,

atëherë shifrat e dëmeve dhe rikuperimet e e pasurive private apo shtetërore do të ishin disa herë më të larta. Ne duhet te jemi tek çdo klient sepse tek secili është një potencial për sigurimet dhe këtë duhet ta bejme të gjithë”, vijoi më tej CEO i SIGAL UNIQA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, z. Avni Ponari.

“Ka disa momente të rëndësishme në historinë e dëmeve:

Çdo sigures kërkon dhe dëshiron të paguajë të dëmtuarin drejtëpërdrejtë ndaj dhe kërkesat në këtë drejtim janë rritur dhe gjërat po ecin në rrugën e duhur me qytetarët që janë ndërgjegjësuar mbi dëmet dhe si duhen kërkuar ato në kompanitë e sigurimeve.

Njerëzit i duan sigurimet por nuk duan të paguajnë primin, prandaj siguresit janë dhe duhet të jenë këmbengulës në pagesat e primeve”, u shpreh z.Ponari.

Pas fjalës së zotit Ponari, i cili drejtoi edhe workshop-in, fjalën e morën drejtues të departamenteve të dëmeve në të tre shtetet, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku secili foli mbi punën e kryer gjatë vitit 2021, dëmet e paguara dhe rëndësinë që grupi më i madh i sigurimeve në rajon u jep pagimit të dëmeve brenda kuadrit ligjor në fuqi.

SIGAL UNIQA mes TOP 100 kompanive të sigurimit në Europën Juglindore



Viti 2022 ishte një vit sukcesi për SIGAL UNIQA Group Austria.

Kompania më e madhe e sigurimeve në vend rikonfirmoi edhe një herë rolin e liderit në treg, si në produktet e Sigurimit të Jetës, të Jo-jetës dhe Pensionin Privat.

Por përveç besimit në rritje të qytetarëve, të cilët i besojnë jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat, nuk kanë munguar as çmimet kombëtare dhe ndërkombëtare për kompaninë.

Revista prestigjioze “See News” publikoi listën e 100 kompanive më të mëdha të sigurimeve në Evropën Juglindore përgjatë vitit 2021.

SIGAL UNIQA Group Austria renditet në vendin 51, duke pësuar rritje të konsiderueshme me 11 vende, nga vendi i 62-të ku ndodhej në vitin

2020.

Për herë të parë këtë vit, në “TOP 100 Insurers” është përfshirë edhe SIGAL Uniqa Group Austria Kosova, duke u renditur në vendin e 98-të.

“SeeTOP 100” është një renditje vjetore e kompanive më të mëdha në Evropën Juglindore, sipas të ardhurave totale për vitin fiskal 2021. Ajo mbulon kompanitë financiare të regjistruara në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Moldavi, Mali i Zi, Rumani, Serbi dhe Slloveni.

“Finance Central Europe”, revista prestigjioze, dedikuar tregjeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, ka vlerësuar me 6 çmime kompaninë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, SIGAL UNIQA Group Austria.

Me seli qëndrore në Mbretërinë e Bashkuar dhe dedikuar tregjeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore, revista akordon çmimet në fjalë në raport me drejtimin, performancën, fuqinë e aseteve, kapitalin, primet neto, dhe fitimet e kompanisë.

Revista në fjalë vlerëson SIGAL UNIQA Group AUSTRIA me çmimet:

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fuqisë së aseteve për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fuqisë së kapitalit për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas primeve neto të sigurimeve për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fitimeve para tatimeve për vitin 2021/22”

“Kompania më e mirë e sigurimeve në Shqipëri sipas fitimeve mbi asetet për vitin 2021/22”

Vlerësimet më të fundit nga “Central Finance Europe” vijnë në vazhdim të çmimeve dhe vlerësimeve të tjera që SIGAL UNIQA ka marrë gjatë vitit 2021 dhe më herët.

“TOP 100 kompanitë më të mëdha” nga revista Monitor (Vendi i parë sa i përket kompanive të sigurimit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut).

Pavarësisht pandemisë COVID-19 dhe tërmeteve të vitit 2019, kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon SIGAL UNIQA Group Austria kaloi një vit të suksesshëm duke u renditur nga revista “Monitor” mes Top 100 kompanive më të mëdha në vend dhe numri 1 sa i përket atyre të sigurimeve.

Kjo vjen si pasojë e seriozitetit në marrëdhëniet me klientët, produkteve unike në treg dhe pagimin në kohë të dëmeve. Këto janë disa prej shumë arsyeve që e bëjnë SIGAL UNIQA-n lidere në tregun e sigurimeve.

Gjatë vitit që lamë pas SIGAL UNIQA Group AUSTRIA-s iu akordua Çmimi “SUPERBRANDS



ALBANIA'S CHOICE 2019/2020” nga prestigjiozia “SUPERBRANDS INTERNATIONAL”

Ky Çmim i ofrohet brandeve më të dalluara në fushën e tyre – për SIGAL UNIQA, në industrinë e sigurimeve në Shqipëri – si edhe si një tregues i qartë për pozicionin solid të brandit, prestigjin e biznesit të përfaqësuar, kënaqësinë, besimin dhe garancinë e klientëve.

Kujtojmë se SIGAL UNIQA e merr këtë çmim për të disatën herë rradhazi.

Ndërkohë vlerësimet nuk kanë munguar as për kompaninë më të SIGAL, UNIQA Insurance Group.

Në bashkëpunim me Statista, revista prestigjioze “Forbes” vlerësoi 20,000 kompani për të gjetur punëdhënësin më të mirë në botë.

Nga 20,000 kompani të vlerësuara nëpër botë në renditjen ndërkombëtare të punëdhënësve nga revista prestigjioze “FORBES”, UNIQA Insurance Group renditej mes 3 kompanive më të mira të sigurimit në Evropë dhe në vend të 395-të në botë.

Rezultati bëhet edhe më i kënaqshëm kur merret parasysh se në sondazh morën pjesë 150,000 punonjës nga 58 vende të ndryshme.

Ndërsa në shkurt 2020, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim kanë vlerësuar filantropinë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA duke i akorduar “Çmimin e Filantropisë 2019” në Nivel Kombëtar me motivacionin: “Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjedis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve, ku veçohen: Klinika Lëvizëse Mjekësore në shkallë vendi, rikonstrukcioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Matosh UKA” në Fierzë, Tropojë dhe Pallatit të Sportit në Përmet, si dhe krijimi i Klubit “Art dhe Kulturë” në dispozicion për të gjithë qytetarët e Durrësit”.

Por nuk kanë munguar çmimet dhe vlerësimet as për CEO-n dhe themeluesin e kompanisë, z. Avni Ponari.

Nga “Finance Central Europe”:

- “Drejtuesi më i mirë i kompanisë së sigurimeve në Shqipëri për vitin 2021/22”

- “Drejtuesi më i mirë i kompanisë së sigurimeve në Evropën Juglindore për vitin 2021/22”.

VLERËSIME DHE TITUJ TË TJERA

- “Çertifikatë Mirënjohjeje” nga Senati Akademik i Universitetit European të Tiranës në kuadër të “Vitet të Solidaritetit” (2020);

- “CEO Revolucionar për vitin 2020 për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në botën e biznesit” nga Business Sight Magazine (2020);

